




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Kuvendi - Skupština - Assembly

Tabela e Rezultateve 2020

Emri i projektit

Mbështetje për një Qeverisje përgjegjëse, efektive dhe llogaridhënëse në Kosovë Financuar nga USAID Implementuar nga NDI



Rezultatet nga mbështetja gjate vitit 2020

Në nivel të administratës:

I. Promovimi i integritetit politik dhe transparencës së legjislativit (organit ligjvënës)

1. Drejtoria për Media është mbështetur në hartimin e manualit për menaxhim të mediave sociale.
2. Kuvendi ka miratuar Rregulloren për Media dhe Qasjen e Publikut në Punën e Kuvendit, të hartuar nga Drejtoria për Media dhe gazetarët e akredituar, mbështetur nga NDI-ja.
3. Ka angazhuar, në mënyrë virtuale, më shumë se 200 nxënës të rinj nga shkollat fillore të Prishtinës në Punëtoritë e Demokracisë.
4. Drejtoria për Media dhe marrëdhënie me publikun është mbështetur për krijimin dhe lansimin e këndit edukativ "Parlamenti i fëmijëve" në faqen e internetit të Kuvendit.
5. Lansimi i videos edukative "Kuvendi ynë" dhe materiale të tjera të ngarkuara në "Parlamenti i fëmijëve".

II. Përmirësimi i funksioneve legjislative dhe mbikëqyrëse

1. Organizimi i programit trajnues për këshilltarët ligjorë të Departamentit të Shërbimit Ligjor.
2. Organizimi i programit trajnues për analiza buxhetore dhe financiare për stafin e DRLA-s dhe stafin e komisioneve.
3. Zhvillimi i një programi mentorimi për analistët buxhetor të DRLA-së për përgatitjen e analizës buxhetore për Raportin e Shpenzimeve të Buxhetit për vitin 2019.
4. Zhvillimi i një programi mentorimi për analistët buxhetor të DRLA-së për përgatitjen e analizës buxhetore për Projektligjin për Buxhet të Republikës së Kosovës për vitin 2021.
5. Program trajnimi për shkëmbim virtual të përvojës rreth "ofrimit të shërbimeve cilësore kërkimore për anëtarët e komisioneve" për hulumtuesit e DRLA-së (tre pjesëmarrës nga Kosova). Ky program është organizuar nga Dhoma e përfaqësuesve të Partneritetit për Demokraci (HDP) i Kongresit Amerikan.
6. Punëtori virtuale për anëtarët e Departamenteve të Kërkimit nga Parlamentet e Ballkanit Perëndimor mbi vizualizimin e të dhënave - Praktikat e mira dhe sfidat ekzistuese.
7. Shkëmbim ndërmjet shërbimeve juridike të Kuvendit të Kosovës dhe Kuvendit të Shqipërisë me temën "Si u janë përgjigjur parlamentet kufizimeve të vendosura nga COVID-19 - sfidat dhe mundësitë".

Niveli i politikës

II.Promovimi i integritetit politik dhe transparencës së legjislativit (organit ligjvënës)

1. Mbështetja e Kuvendit për krijimin e Forumit për Transparencë Parlamentare dhe hartimi i planit vjetor të punës.
2. Është bërë vlerësimi bazë i Planit të Veprimit të Kosovës për një Kuvend të hapur dhe transparent (2016-2020).
3. Është organizuar një takim virtual midis deputetëve dhe OSHC-ve dhe palëve të interesuara përkatëse mbi "Pandeminë- Rimëkëmbja Ekonomike"
4. Është organizuar një diskutim virtual midis deputetëve dhe studentëve të rinj (Ballë për ballë me Parlamentarët)
5. Publikimi i listës kërkimore në faqen e internetit të Kuvendit (Transparenca Parlamentare)

Grupi i grave deputete

1. Diskutim virtual midis grave parlamentare nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut.
2. Diskutim virtual midis deputeteve të Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës me qëllim të shkëmbimit të pikëpamjeve se si kriza e shkaktuar nga pandemia ka prekur gratë dhe grupet e tjera të prekshme (cenueshme) në të gjitha vendet përkatëse.
3. Ka lehtësuar (fasilituar) diskutimin virtual në temën "Dhuna në familje në kohë pandemie" e iniciuar nga deputetet e Kosovës Valdete Idrizi dhe Saranda Bogujevci Diskutimi virtual me temën "Komunitetet jo-shumicë (pas) pandemisë" ndërmjet deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe përfaqësuesve të institucioneve qeveritare dhe jo-qeveritare.
4. Janë organizuar dy punëtori me temën "Përgatitja e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e duhur të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve".
5. Në bashkëpunim me Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsion është mbështetur Grupi i Grave Deputete për organizimin e punëtorisë me temë "Mbrojtja e të drejtave të njeriut përmes Draft-Kodit Civil".
6. Është përkrahur krijimi dhe përbërja e Grupit të Grave Deputete, Grupit të Rinjve dhe Grupit të Gjelbër.
7. Së bashku me drejtuesit e Grupit të Gjelbërve dhe të Rinjve janë hartuar planet përkatëse të punës.
8. Në bashkëpunim me bordin dhe partnerët strategjikë të Grupit të Grave Deputete, është organizuar një punëtori për diskutim dhe miratim të planit të punës për muajt shtator-dhjetor 2020.
9. Në bashkëpunim me Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër është përkrahur Grupi i Grave Deputete për organizimin e një punëtorie, për ta diskutuar Draft Kodin Civil me Organizatat e Shoqërisë Civile.

Grupi i të Rinjve dhe të Gjelbërve

11. Grupi i Grave Deputete dhe të Rinjve mori ndihmë nga NDI përmes angazhimit të një eksperti, ku është bërë një raport i analizës buxhetore nga perspektiva gjinore dhe e rinisë për projektligjin për Buxhet për vitin 2021.
12. Është përkrahur Grupi i të Gjelbërve për zhvillimin e një punëtorie me përfaqësuesit e shoqërisë civile me temën "Potenciali energjetik i Kosovës dhe çështjet mjedisore.
13. Në bashkëpunim me PIPS është asistuar Grupi i të Gjelbërve për organizimin e një takimi me gazetarët që mbulojnë temat në lidhje me çështjet mjedisore në Kosovë.
14. Është fasilituar organizimi i një diskutimi virtual midis Grupit të të Rinjve dhe Rinisë nga komunitetet serb-folëse me temën "Potenciali i pjesëmarrjes së të rinjve të Kosovës në proceset e vendimmarrjes dhe sfidat me të cilat përballen".

I. Përmirësimi i funksioneve legislative dhe mbikëqyrëse

1. Mbështetja e procesit të hartimit të Rregullores së Punës së Kuvendit (RoP), duke ndërtuar vullnetin politik për të punuar në Rregullore të Punës, dhe mbështetja e Komisionit për Legjislacion në procesin e hartimit.
2. Mbështetja e komisioneve parlamentare përmes analizës buxhetore në organizimin e dëgjimeve buxhetore për mbikëqyrjen e shpenzimeve të qeverisë për vitin 2019 dhe rishikimin e parashikimeve të buxhetit për vitin 2021.


Emri i projektit

Mbështetje për Procesin e Integrimit Evropian në Kosovë Financuar nga Bashkëpunimi Gjerman për Zhvillim Implementuar nga GIZ

Rezultatet nga mbështetja gjatë vitit 2020

Niveli i administrates

1. Program individual dhe grupor i coaching (me 18 pjesëmarrës të sesioneve individuale)
2. Hartimi i Planit Strategjik 2021-2025
3. Trajnime dhe certifikime në: përafrimin e legjislacionit, Kapitujt e legjislacionit të BE-së, Teknikat e komunikimit, Komunikimi i procesit të MSA, Instrumenti i Para-anëtarsimit.



Niveli i politikës

1. Tryeza diskutimi mbi temat kyçe në procesin e Integrimit Evropian (Raporti i BE-së për Vendlindjen, Zgjedhjet Parlamentare në BE, Samiti i Zagrebit, Presidenca Gjermane e BE-së) duke përfshirë Shoqërinë Civile dhe Mediat.
2. Mbështetje në hartimin e Planit të Punës së Komisionit për Integrim Evropian.
3. Zhvillimi i Planit për Mbikëqyrje të Procesit të Integrimit Evropian 2020-2021.

Të përgjithshme

1. Zhvillimi i raporteve informuese mbi temat kyçe të BE-së (Zhvillimet e fundit në BE, Plani Investiv dhe Ekonomik i BE-së, Raporti për Vendlindjen)
2. Zhvillimi i videos virtuale të Kuvendit
3. Zhvillimi i videove informuese mbi Rolin e Kuvendit, Procesin Legjislativ dhe Punën e Komisioneve Parlamentare

Emri i projektit

Kontributi në promovimin e qeverisjes së mirë dhe hartimin e legjislacionit pjesëmarrës dhe monitorimin Financuar nga Ambasada e Holandës Implementuar nga Fol dhe D+

Rezultatet nga mbeshtetja gjate vitit 2020



Niveli i administrates

1. Përkrahja e Kabinetit të Kryetares së Kuvendit me dy praktikantë;
2. Organizimi i matjes së opinionit publik të qytetarëve në mënyrë elektronike për dëgjimet publike të mbajtura nga komisionet parlamentare.

Niveli i politikës

1. Monitorimi i zbatimit të dy ligjeve (Ligji për Qasjen në dokumentet publike dhe Ligji për Organizmin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe Agjencie të pavarura), për të nxitur rritjen e performancës së Kuvendit në zhvillimin e aktiviteteve mbikëqyrëse;
2. Pesë ligjërata me studentë, për të rritur njohuritë e tyre rreth rolit dhe aktiviteteve të Kuvendit, si dhe vetëdijen e të rinjve për luftimin e korrupsionit
3. Katër takime të përbashkëta virtuale në mes të deputetëve dhe studentëve për të ndërtuar ura të komunikimit;
4. Analizë e detajuar e amendamenteve të ligjeve nga fusha e luftimit të korrupsionit dhe integritimit evropian, për të rritur komentet dhe kontributin në këtë fushë.

Emri i projektit

Agjencitë e OKB-së në Kosovë



Rezultatet nga mbështetja gjate vitit 2020

Niveli i administrates

1. Zhvillimi i Strategjisë së veprimit për Grupin e Deputetëve të rinjë me mbështetjen e UNomen (në proces)
2. Marrëdhënia me Publikun e Grupit të Grave Deputete – Mbështetja nga UN Women me Zyrtare për marrëdhënie me publikun
3. Plani Vjetor i Grupit të Grave Deputete për gjysmën e dytë të vitit 2020, mbështetur nga NDI, OSCE dhe UN omen
4. Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Grave “Let’s talk GenerationEquality” me kryetaren e Parlamentit mbështetur nga UN Women (8 mars 2020)
5. Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të vajzave nga Kuvendi i Kosovës, mbështetur nga UNKT dhe UN Women (11 tetor 2020)
6. Fushata 16 Ditë të aktivizmit kundër dhunës në baza gjinore me GGD – (Ndriçimi i ndërtesës së Kuvendit)
7. Shënimi i Ditës së Fëmijëve
<https://www.facebook.com/rtklivecom/posts/10158133877818859>
8. Shënimi i Javës së Zhvillimit të Qëndrueshëm, UNDCO me UNKT
<https://www.facebook.com/UNKosovoTeam/posts/3382499701837948>
9. Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve Girdl nga UNKT me udhëheqjen e UN Women.
10. Shënimi i muajit të Ngritjes së vetëdijes të kancerit të gjirit në Kuvendin e Kosovës-nën udhëheqjen e UNFPA
<https://www.twitter.com/UNKosovoTeam/status/1321468548280127504?s=20>
11. UNDP mbështeti Avokatin e popullit për të organizuar seanca të rregullta pune ndërmjet Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Institucionit të Avokatit të popullit dhe autoriteteve përgjegjëse, për të diskutuar rekomandimet e Avokatit të popullit dhe veprimet pasuese, duke kontribuar kështu në përmirësimin e mbikëqyrjes parlamentare mbi institucionet ekzekutive (projekti i Sundimit të Ligjit / Qasja në Drejtësi).
12. UNDP organizoi një Ëebinar në Ditëne Demokracisë "E ardhmja që duam të shohim - demokracia dhe sundimi i ligjit në kohë krize", për të diskutuar në lidhje me ndikimin e Covid-19 në kontekstin e sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut (Sundimi i Ligjit / Qasja për projektin e drejtësisë).
13. UNDP dhe UNV përmes “Mbështetjes së Institucioneve të Kosovës me zgjidhje të shpejta dhe inovative për të përmbajtur përhapjen e pandemisë COVID-19” kanë mbështetur Kuvendin duke dhuruar pajisje për video-konferenca, dhe kane blerë licencat Zoom për një vit dhe sistemin e videokonferencës CISCO EBEX.

Emri i projektit

Zhvillimi i Shërbimit Informativ për ligjet (Sistemi 'LawData') dhe konsistenca gjuhësore e ligjeve Financuar nga Ambasada e Norvexhisë Implementuar nga IMG dhe ECMI

Rezultatet nga mbeshtetja gjate vitit 2020

Niveli i administrates



Qëllimi kryesor i Projektit është që të fuqizohet dhe promovohet transparenca dhe efikasiteti i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe institucioneve tjera shtetërore të sundimit të ligjit në Kosovë.

Komponenta 1: Zhvillimi i Sistemit Informativ Ligjor- Sistemi 'LawData'

Sistemin LawData, do të ofroj shërbime falas 'online' për publikun e gjerë, juristët, etj, në ligje dhe akte nënligjore të strukturara dhe konsoliduara, dhe do t'u mundësoj një qasje më të lehtë në ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Kontraktori (Kompania e përzgjedhur) "Cactus" ka filluar punën;

Komponenta II. Konsistenca gjuhësore ka të bëjë me shpërputhjet gjuhësore të ligjeve dhe rregulloreve që janë të aplikueshme në Kosovë.

Përmes sistemit LawData do të bëhet strukturimi i tekstit të akteve juridike dhe do të konsolidohen amandamentet apo ndryshim plotësimet e tyre në tekst të veçantë. Version fillestar i specifikave të software-it LawData është finalizuar

Emri i projektit

Zhvillimi i kapaciteteve, të bashkëpunimit dhe kulturës në mbikëqyrjen e sektorëve të sigurisë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni të Veriut (DECOS) - Themeluar nga Ministria e Holandës për Punë të Jashtme.)

Implementuar nga Qendra Evropiane për Studimet e Sigurisë (CESS) nga Holanda, në bashkëpunim me partneret lokal KIPRED (Kosovë), IDM dhe ISP (Shqipëri) dhe IDSCS (Maqedonia e Veriut)



Rezultatet nga mbështetja gjate vitit 2020

Niveli i administrates

1. Si pjesë e projektit DECOS, CESS ka organizuar një punëtori online për 6 deputetë të Komisionit AKI (dhe një anëtar të stafit). Gjatë kësaj punëtorie një folës nga Parlamenti i Holandës ka prezantuar bazën ligjore të komisionit holandez parlamentar për mbikëqyrje të inteligjencës dhe ka folur për mbështetjen që komisioni i saj e merr nga organet e jashtme të ekspertëve (jashtë parlamentit).
2. Dy anëtar të stafit nga komisioni i AKI-së dhe komisionit për siguri kombëtare kanë marr pjesë në pesë sesione online të grupit punues, për ‘implikimet e pandemisë Covid 19 në qeverisje dhe sigurinë njerëzore në Ballkanin Perëndimor’.
3. Një anëtar i stafit nga komisioni i AKI-së merr pjesë në pesë takime online të grupit punues mbi ‘mbikëqyrjen e inteligjencës’

Niveli i politikës

1. Mbështetje për Komisionin Parlamentar të AKI-së

Emri i projektit

DCAF

Nxitja e kapaciteteve të Kuvendit të Kosovës për mbikëqyrje dhe rregullim ligjor të sektorit të sigurisë në Kosovë në pajtueshmëri me normat ndërkombëtare, standardet dhe praktikrat e mira

Rezultatet nga mbështetja gjate vitit 2020



Përfituesit kryesorë

Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes
Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë
Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore (me fokus tek aktivitetet që kanë të bëjnë me sektorin e sigurisë)

Në nivelin administrativë:

Objektiva: Rritja e njohurive dhe shkathtësive të ekspertëve që janë staf i Kuvendit të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me qeverisjen e sektorit të sigurisë dhe mbikëqyrjen parlamentare të sektorit të sigurisë

Grupi i synuar: Staf mbështetës që shërbejnë në Komisionin për Siguri dhe Mbrojtje dhe Komisionin për Mbikëqyrje të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë.

Aktivitetet: Përfshirja e dy ekspertëve, anëtarë të stafit të Kuvendit të Kosovës, në një trajnim rajonal të përshtatur për nevojat e stafit parlamentar që shërben në komisionet e përhershëm të mbrojtjes, sigurisë dhe mbikëqyrjes së inteligjencës në Ballkanin Perëndimor. Fokusi kryesor: “Kërcënimet aktuale ndaj sigurisë dhe sfidat në mbikëqyrje”.

Rezultatet: Rritja e njohurive mbi kërcënimet rajonale ndaj sigurisë; metodologjia për zgjerimin evropian ndikimi i Covid-19 në mbikëqyrjen parlamentare të sektorit të sigurisë

Vërejtje: Ekspertet, anëtar të stafit, janë gjithashtu të përfshirë në të gjitha ngritjet e kapaciteteve të DCAF të përshtatura për Komisionin për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes; Komisionin për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë; dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore; shihni më poshtë rezultatet përkatëse;

Niveli i politikës

Objektiva 1: Shtimi i ekspertizës për anëtarët dhe stafin që shërben në Komisionin e Kuvendit të Kosovës për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes për të përforcuar kapacitetet e Komisionit në mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë të Kosovës.

Fokusi:

- Lehtësimi i bartjes së njohurive dhe ekspertizës mbi rritjen e integritetit të policisë dhe ofrimi i platformës për të diskutuar rëndësinë dhe implikimet për Kosovën;
- Sigurimi i njohurive të ekspertëve mbi ndikimin e Covid-19 në punën e institucioneve të sigurisë me fokus të veçantë tek implikimet për sektorin e mbikëqyrjes parlamentare të sigurisë.

Aktivitetet: Shkëmbimi i ekspertëve mbi Qeverisjen në Sektorin e Sigurisë në Kosovë me fokus tek

- Ndërtimi i integritetit të policisë Police – rëndësia dhe implikimet për Kosovën -
- Ndikimi i COVID-19 në qeverisjen e sektorit të sigurisë dhe implikimet për mbikëqyrjen parlamentare

Rezultatet: Ekspertizë e shtuar të anëtarëve të Komisionit dhe stafit për ndërtimin e integritetit të policisë në Kosovë dhe mbi ndikimin e Covid-19 mbi qeverisjen e sektorit të sigurisë dhe mbikëqyrjen parlamentare

Objektiva 2: Ekspertizë e shtuar të anëtarëve dhe stafit që shërben në Komisionin e Kuvendit të Kosovës për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës të Inteligjencës për të përforcuar kapacitetet e Komisionit për mbikëqyrjen e sektorit të inteligjencës;

Fokusi:

- Lehtësimi i bartjes së njohurive dhe ekspertizës mbi mbikëqyrjen e inteligjencës dhe llogaridhënien me fokus tek mbikëqyrja parlamentare të shërbimeve të inteligjencës ;
- Sigurimi i platformës për shkëmbimin me ekspertet e lartë të inteligjencës dhe ekspertet e DCAF mbi mbikëqyrjen parlamentare dhe mundësimi i një debati mbi rëndësinë e temës për kontekstin në Kosovë.

Aktiviteti: Shkëmbimi i ekspertëve mbi llogaridhënien e inteligjencës – kontrollin e brendshëm dhe të jashtëm dhe mekanizmat e mbikëqyrjes

Rezultati: Ekspertizë e zgjeruar mbi mbikëqyrjen e inteligjencës dhe llogaridhënien me fokus tek mbikëqyrja parlamentare të shërbimeve të inteligjencës;

Emri i projektit

“Promovimi i një procesi të mirëinformuar dhe pjesëmarrës në fazën finale të dialogut Kosovë – Serbi” i mbështetur nga Ambasada e Zvicrës dhe Ambasada e Gjermanisë në Kosovë

Rezultatet nga mbështetja gjate vitit 2020



Në funksion të rritjes së transparancës lidhur me dialogun Kosovë- Serbi, si dhe llogaridhënies së ekzekutivit ndaj Kuvendit për këtë proces, gjatë vitit 2020, KDI ka realizuar aktivitetet e mëposhtme:

- Takim koordinues mes komisioneve parlamentare në lidhje me procesin e dialogut;
- 6 materiale informuese, me pyetje dhe çështje për t’u adresuar nga deputetët gjatë zhvillimit të seancave ku është trajtuar çështja e dialogut;
- 5 materiale informuese komisioneve parlamentare lidhur me zhvillime që preken nga marrëveshjet e dialogut apo dialogu në përgjithësi;
- 6 takime konsultuese me komisionet parlamentare për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta me KDI-në,
- 2 pako informuese për anëtarët e komisioneve parlamentare, para realizimit të vizitave në terren;
- 1 vizitë në terren tek institucionet/organet përgjegjëse për zbatimin e marrëveshjeve të dialogut /çështjeve të ndërlidhura me të;
- Takim i përbashkët me Kuvendin e Kosovës, i përfaqësuar nga Kryetarja e Kuvendit, dhe delegacionit nga Ministria e Punëve të Jashtme e Zvicrës

Emri i projektit

Misioni i OSBE-së në Kosovë Mbështetja e Kuvendit të Kosovës, 2020

Për shkak të shpërthimit të pandemisë COVID-19, misioni i OSBE-së nuk ka pasur mundësi t'i zbatoj disa nga aktivitetet e planifikuara për vitin 2020.

Mbështetja e Grupit të Grave Deputete:

- Në fillim të vitit 2020, Misioni zhvilloi një varg konsultimesh me gratë deputete në mënyrë që të bëhet një vlerësim i nevojave individuale të grave deputete dhe Grupit të Grave Deputete në përgjithësi duke synuar përshtatjen e mbështetjes me nevojat e paraqitura.
- Në korrik, pas kërkesës së bërë nga Grupi i Grave Deputete, Misioni rishikoi aktivitetet e parapara, dhe propozoi aktivitete të reja, si dhe identifikoi fushat që OSBE-ja mund t'i mbështesë në zbatimin e aktiviteteve të identifikuar në draft planin e punës.
- Në shtator, Misioni mbështeti Grupin e Grave Deputete në organizimin e një punëtorie për të rishikuar dhe miratuar planin e tyre të punës për vitin 2020. Ngjarja shërbeu si një platformë për pjesëmarrësit për të shqyrtuar çdo aktivitet veçmas, për të ndarë përgjegjësitë midis anëtarëve të grupit parlamentar dhe për të identifikuar organizatat që do ta mbështesnin teknikisht dhe / ose financiarisht grupin e lartë përmendur në zbatimin e aktiviteteve të parapara, për pjesën e mbetur të vitit 2020.
- Më 24 shtator, pas kërkesës së bërë nga Grupi i Grave Deputete, Misioni zhvilloi një sesion informues mbi Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, e njohur si Konventa e Stambollit. Në këtë sesion informues u dha një përmbledhje e standardeve të Konventës, përgjegjësi që rrjedhin prej saj, si dhe rolin e Asamblesë në këtë proces.
- Në nëntor dhe dhjetor, Misioni mbështeti Grupin e Grave Deputete përmes katër debateve televizive në RTK, me qëllim të rritjes së dukshmërisë së grupit parlamentar. Mbështetja u përqendrua në promovimin mediatik të grave deputete, si dhe promovimit të Grupit të Grave Deputete, përmes mbajtjes së një varg debatesh televizive në RTK dhe në programet televizive të televizioneve lokale. Temat e trajtuara ishin: Draft Kodi Civil - kapitujt mbi familjen dhe trashëgiminë, Ligji për Zgjedhjet dhe harmonizimi i tij me Ligjin për Barazinë Gjinore, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (me fokus në shërbimet speciale që përfshijnë strehimoret dhe qendrat ditore të fëmijëve), dhe sfidat me të cilat përballen gratë në politikë.



Mbështetja e Rishikimit Legjislativ të draft Kodit Civil :

- Gjatë sesionit vjeshtor, me kërkesë të Grupit të Grave Deputete, Misioni mbështeti këtë grup në shqyrtimin e rekomandimeve dhe propozimeve, të dhëna nga organizatat e shoqërisë civile (OShC) në lidhje me Kodin Civil. OShC-të dëshironin të përfshiheshin në procesin e hartimit, dhe për këtë arsye iu drejtuan Grupit të Grave Deputete për t'iu mundësuar atyre që të ndajnë shqetësimet e tyre dhe t'i përfshijnë ato në përputhje me rrethanat. Mbështetja e Misionit për Grupin e Grave Deputete në këtë drejtim ishte përqendruar kryesisht në analizimin e ndikimit ligjor dhe financiar të rekomandimeve të OShC-ve në draft Kodin Civil.

Mbështetja e grupeve parlamentare me këshilla ligjore:

- Duke iu përgjigjur një kërkesë të bërë nga deputetët, Misioni rekrutoi një ekspert ligjor për t'i mbështetur deputetët serbë të Kosovës me këshilla ligjore, si dhe për t'i mbështetur këta të fundit në shqyrtimin e draft legjislacionit.

Mbështetja e komisioneve në hartimin e draft planeve vjetore të punës :

- Në shkurt, Misioni mbajti një punëtori dy-ditore me stafin e komisionit të Kuvendit për hartimin e planeve vjetore të punës së komisioneve për vitin 2020. Në punëtorin e lartpërmendur, stafi hartoi planet e punës për të gjitha komisionet e themeluara të Kuvendit. Mbështetja u përqendrua kryesisht në rritjen e aktiviteteve mbikëqyrëse, si dhe hartimin e një plani realist dhe efektiv të punës në përputhje me Planin Strategjik 2016-2020 të Kuvendit .

Standardizimi i procesit të hartimit të ndryshimeve (amendamenteve) në nivel të komisionit :

- Misioni mbështeti standardizimin dhe strukturimin e procesit të hartimit të ndryshimeve (amendamenteve) në nivel të komisionit. Gjatë vitit 2020, një ekspert i lartë ligjor, i rekrutuar nga vetë Misioni, analizoi kornizën ligjore dhe praktikën në këtë fushë. Si pjesë e këtyre përpjekjeve, Misioni mbështeti administratën e Kuvendit, për ta vizituar Parlamentin e Kroacisë dhe për të mësuar më shumë rreth praktikave më të mira në këtë fushë.

Mbështetje e vazhdueshme teknike për komisionet e synuara (targetuara):

- Misioni ka ofruar mbështetje të vazhdueshme teknike për komisionet e synuara (targetuara) përmes dërgimit të një grupi ekspertësh për fushën ligjore dhe atë financiare. Katër ekspertët e rekrutuar kanë ofruar ekspertizë teknike çdo ditë për: Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsion; Komisionin për Buxhet dhe Transfere; Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim; Komisionin për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike; Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Zhdukur dhe Peticione; dhe Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Promovimi i transparencës:

- Duke iu përgjigjur një kërkesë të bërë nga ish Kryetari i Kuvendit dhe Sekretari i Gjeneral i Kuvendit, Misioni ka mbështetur rritjen e transparencës përmes aplikimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit. Eksperti ndërkombëtar i rekrutuar nga Misioni kreu një vlerësim të nevojave dhe zhvilloi termat e referencës dhe specifikimet teknike për sistemin e ri elektronik të seancave të Kuvendit duke përfshirë një sistem të ri të integruar audio-vizual për përgatitjen, regjistrimin, rishikimin, transmetimin dhe arkivimin e takimeve.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Kuvendi - Skupština - Assembly

www.kuvendikosoves.org